



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.22.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR
UJË DHE KANALIZIM PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendos në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Udhëheqësja e Ekipit, Mirlinda Beqiri dhe anëtari, Hysen Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJËS

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	21
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	24


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, në dhjetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


Opinion i Kualifikuar

Përveç efekteve të çështjes për mbi pagesën dhe keqklasifikimin të përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti varësisht prej lloji të opinionit

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm - auditimi 2015

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim (ZRRUK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të ZRRUK-ut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194 dhe Rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Shpenzimet për blerjen e antivirusit në vlerë prej 3,600€ janë paguar nga buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve. Blerja e antivirusit përmban të gjitha elementet e përkufizimit si pasuri kapitale dhe një blerje e tillë duhet të buxhetohet dhe realizohet nga kategoria e Investimeve Kapitale.

Gjithashtu pagesa e dyfishtë e faturës në vlerë 3,397€ për printim të “Raportit vjetor të performances 2014” paraqet një gabim financiar i cili ka reflektuar në shpenzimet totale të paraqitura në PVF 2015.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë e tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga ZRRUK dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Drejtori i Përgjithshëm i ZRRUK-ut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme si dhe është përgjegjës për kontrollin brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZRRUK-ut.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi, dhe të japim një opinion të auditimit. Siguria e mjaftueshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarime materiale kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare,

qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

ZRRUK kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Kërkesat buxhetore; raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës), draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetvlerësimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në draft Pasqyrat Financiare ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve si në vijim:

- Në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave dhe Raporti i ekzekutimit të buxhetit, vlerat ishin prezantuar me gabime; dhe
- Shënimi 31 dhe 34, Përmbledhja e Pasurive jokapitale dhe llogarive të arkëtueshme ishin shpalosur me gabime.

Të gjeturat më lartë tregojnë që përgatitja e PVF -ve është menaxhuar në mënyrë të dobët. Si rezultat i auditimit tonë, janë bërë rregullimet në draft pasqyrat vjetore financiare të paraqitura për auditim, në përjashtim të shënimit 31 dhe 34 të evidentuara më lartë.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë përveç klasifikimit të drejtë të shpenzimeve shpalosjeve për pasuritë dhe Llogaritë e Arkëtueshme.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

1.4 Rekomandimet

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** - Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me klasifikimin e shpenzimeve dhe shpalosjet e duhura në PVF. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme apo rishikimet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZRRUK-un që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të te hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin tre të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ZRRUK veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Qe nga mesi i muajit prill të vitit 2015 ZRRUK ka operuar pa menaxhment të lartë dhe si pasojë janë vërejtur ndikimet në zhvillimin e veprimtarisë dhe realizimin e objektivave në ZRRUK, veçanërisht kur është fjala për dhënien e licencave për kompanitë e ujërave. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar ZKF, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të ZRRUK-ut kanë rezultuar në tre rekomandime kryesore. ZRRUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, një rekomandim është implementuar, një është në proces të implementimit, ndërsa rekomandimi i pa implementuar për inkasimin e llogarive të arkëtueshme mbetet prapë sfidë për entitetin. Prandaj, ZRRUK duhet të konsideroj si prioritet këtë fushë të ndjeshme, me qëllim të përfitimit nga arkëtimi i llogarive të arkëtueshme.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ZRRUK-un si më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohen si të vendosura nga ZRRUK;
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga ZRRUK dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion; dhe
- Derisa procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut dhe çështjet e raportimit janë trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1. dhe 2.5.2.

- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi përkatësisht vlerësimin e rrezikut dhe raportimit.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZRRUK operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet sipas procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit-MFK kërkojnë që secila organizatë të identifikoj një regjistër të rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohen arritja e objektivave të asaj organizate si dhe kërkojnë që ky regjistër i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 3 - Kërkesa për Menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

- E gjetura** Pyetësi i vetvlerësimit të plotësuar nga ZKF ka vërtetuar se ZRRUK nuk posedon ndonjë regjistër rreziku me çka kuptohet se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. ZRRUK ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërliken me arritjen e objektivave. Kjo mund të jetë edhe si pasojë që ende nuk është zgjedhur Drejtori Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtori në ZRRUK.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut nuk jep siguri se organizata do të përballlet në mënyrë efikase ndaj sfidave që mund të paraqiten në aktivitetet e saja. Si rrjedhojë mund të ketë ndikim edhe vështirësi në ofrimin e shërbimeve të kërkuara.
- Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 - Raportimi i brendshëm- Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve të brendshme të zbatuara në sistemin kryesor financiar të ZRRUK-it ka nxjerrë në pah dobësi lidhur me raportim financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i ka reduktuar mundësitë për të menaxhuar aktivitetet e ZRRUK-it dhe mund të ndikoj në uljen e efektit në kontrollet buxhetore.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Prokurimi dhe realizimi i shpenzimeve mbetet shqetësim, ne kemi hasur ne raste ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat përkatësisht mbledhjes se tyre janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pagesat e dyfishta dhe gabime tjera eventuale.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ZRRUK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - Realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	382,280	305,517	292,008	324,106	313,213
Granti i Qeverisë -Buxheti	382,280	305,517	292,008	324,106	313,213

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 76,763€. Kjo ulje është rezultat rishikimit të buxhetit si dhe shkurtimeve buxhetore të bëra nga Ministria e Financave.

Në vitin 2015, ZRRUK-i ka përdorur 96% të buxhet final ose 292,008€, me një normë të ngjashme krahasuar me vitin 2014.

¹ Buxheti Final- Buxheti i aprovuar ne Kuvend i përshtatur me vone nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- Realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	382,280	305,517	292,008	324,106	313,214
Pagat dhe Mëditjet	242,412	177,792	177,792	188,455	163,818
Mallrat dhe Shërbimet	133,365	122,237	109,329	130,391	143,958
Shërbimet komunale	6,503	5,488	4,887	5,260	5,438

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Shkurtime buxhetore në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve janë prej 64,620€. Kjo shumë ka qenë e buxhetuar për pagat e menaxhmentit të lartë. Mirëpo vonesat në emërimin e anëtarëve të rinj të menaxhmentit (mos emërimi i tyre) ka bërë që buxheti për pagat e tyre të mbetet i pashpenzuar.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e ZRRUK – Ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	383,632	383,632	336,989	364,370	326,586
Totali	383,632	383,632	336,989	364,370	326,586

Të gjitha të hyrat e arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Krahasuar me vitin paraprak të hyrat kanë një rënie inkasimi prej 7.51% nisur nga fakti që janë arkëtuar vetëm 88% e asaj që është planifikuar.

Çështja 5 - Klasifikim jo i drejtë i shpenzimeve - Prioritet i lartë

E gjetura ZRRUK ka blerë antivirus për 25 kompjuter në vlerë totale prej 3,600€, investim ky i cili është paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve pasi ZRRUK nuk ka të buxhetuara mjete financiare në kategorinë e Investimeve Kapitale. Kjo pasuri në fund të vitit është regjistruar si pasuri kapitale në regjistrat e SIMFK-së.

Rreziku Keq klasifikimet e shpenzimeve shkaktojnë pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve dhe ndikojnë në cilësinë e informatave në PVF, duke mbivlerësuar mallrat dhe shërbimet.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen në kategoritë adekuate për të ofruar një pamje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.

3.4 Prokurimi

Në vitin 2015 ZRRUK kishte nënshkruar 15 kontrata në vlerë prej 10,877€. Tetë prej këtyre kontratave janë realizuar përmes procesit të kuotimit të çmimeve ndërsa pjesa e mbetur përmes procedurave për kontrata më vlerë minimale. Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit.

Çështja 6 - Furnizimi pa procedura të prokurimit - Prioritet i lartë

- E gjetura** ZRRUK ishte furnizuar me kartela grithëse bazuar në një marrëveshje pa procedura të prokurimit. Kjo ishte pasojë e kontrollit të pamjaftueshëm në përzgjedhjen dhe aplikimin e procedurave të duhura të prokurimit.
- Rreziku** Blerjet pa prokurim mund të shpien në marrjen e shërbimeve të nivelit më të dobët nga shërbimet e tregut konkurrues si dhe vlerë të dobët për paratë e shpenzuar.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj realizimin e shërbimeve të telefonisë mobile përmes procedurave të duhura të prokurimit të cilat ofrojnë një blerje transparente dhe konkurruese.

Çështja 7 - Pagesë e dyfishtë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në muajin tetor ZRRUK kishte paguar faturën në vlerë 3,397€ për printim të "Raportit vjetor të performances 2014" në një llogari të mëhershme të OE dhe jo sipas llogarisë bankare të paraqitur në faturë. Përkundër kësaj në nëntor në ZRRUK kishte paguar për të dytën herë faturën e njëjtë në llogarinë e OE të paraqitur në faturë pa e marrë konfirmimin që pagesa paraprake është anuluar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos verifikimit të pagesave nga kontrolli i brendshëm. Këtë çështje e kemi identifikuar gjatë auditimit. Menjëherë pas njoftimit, ZRRUK-u ka filluar procedurat e kthimit të mjeteve nga operatori ekonomik. Megjithatë, kthimi i mjeteve mbetet të rishikohet gjatë auditimit të PVF-ve të vitit 2016.
- Rreziku** Pagesat e njëjta për faturën/mallin e njëjtë shkakton dyfishim të shpenzimeve të organizatës buxhetore si dhe keqpërdorim të parasë publike.
- Rekomandimi 7** Drejtori i përgjithshëm duhet të siguroj funksionimin e kontrolleve adekuate me rastin e aprovimit të pagesave dhe të siguroj që me rastin e raportimit të shpenzimeve të gjitha transaksionet janë të sakta dhe të plota.
-

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Shërbimet e trajnimit dhe mëditjet.

Kjo kategori e shpenzimeve ka pjesëmarrje më të lartë në shpenzimet për mallra dhe shërbime të ZRRUK. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve kanë të bëjnë me shpenzimet e qirasë si dhe kompensimet e anëtarëve të Këshillave Komunale të Konsumatorëve.

Çështja 8 - Pagesa e mëditjeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** ZRRUK kishte kontraktuar një kompani private për organizimin e dy trajnime të ndryshme në Mal të Zi dhe Shqipëri. Në paketën e trajnimeve ishin përfshirë udhëtimi, trajnimi, ushqimi dhe akomodimi². Megjithatë, në dy trajnimet e sipërmendura, katër punonjësve pjesëmarrës iu janë paguar mëditjet e plota. Totali i mjeteve të paguara për gjitha mëditjet ishte 664€.
- Rreziku** Pagesa e mëditjeve për trajnimet për të cilat janë të mbuluara të gjitha shpenzimet krijon kosto shtesë për organizatën.
- Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsiderojë llogaritjen e koston për mënyrën e aplikimit të mëditjeve sipas rregullës për udhëtime zyrtare.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave. ZRRUK gjatë vitit 2015 nuk kishte ndonjë lëvizje të madhe në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në përjashtim të përfundimit të mandatit të Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Shënimi shpjegues i Rregullës për udhëtime zyrtare specifikon se mëditjet prej 20%- para kesh në dorë për punonjësit e saj, paguhen nëse organizatori apo donatori paguan të gjitha shpenzimet e udhëtimeve zyrtare.

3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga ZRRUK në 2015 ishin në vlerë 336,989€ rreth 7.5% më të ulëta krahasuar me vitin e kaluar. Ato kanë të bëjnë me taksat e aplikimit dhe taksa vjetore e licencimit të kompanive të ujësjellësve rajonal.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2015 ZRRUK nuk kishte të planifikuar ndonjë blerje për pasuritë kapitale ndonëse gjatë vitit ka pasur shtim në vlerën blerëse të këtyre pasurive krahasuar me vitin paraprak.

ZRRUK kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë të cilët kanë bërë inventarizimin dhe raportimin e tyre.

Çështja 9 - Veturat Zyrtare - Prioritet i mesëm

E gjetura Pesë vetura zyrtare të ZRRUK-ut ende kanë regjistrim me targa civile. Sipas agjencisë në fillim të aplikimit të targave 5Z, ZRRUK e kishte kërkuar ndërrimin e tyre por një gjë nuk ishte aplikuar nga Qendra e Regjistrimeve të Automjeteve për shkak të mungesës së tabelave.

Rreziku Mbajtja e veturave zyrtare me targa civile, përjashton mundësinë e monitorimit të drejtë e që mund të rezultojë me përdorimin e paarsyeshëm të tyre.

Rekomandimi 9 Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë përpjekjet për të siguruar se të gjitha automjetet që i përkasin agjencisë janë regjistruar si automjete zyrtare dhe të vazhdojë përpjekjet për të siguruar tabelat zyrtare duke ndjekur kërkesat e duke ndjekur kërkesat e UA përkatës.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Saldo e llogarive të arkëtueshme në shpalosjet e PVF-ve ishte 63,299€. Këto obligime janë nga kompanitë e ujërave lidhur me taksën vjetore të ngarkuar nga ZRRUK-u. Kjo vlerë krahasuar me vitin e kaluar paraqet një rritje prej rreth 200% si dhe paraqet një shqetësim serioz lidhur me menaxhimin e kësaj kategorie. Totali i të hyrave që pritej të mblidheshin gjatë vitit 2015 arrinte vlerën 406,300€ përfshirë edhe mjetet e pa mbledhura nga viti paraprak. ZRRUK gjatë këtij viti kishte mbledhur të hyra në vlerë 336,989€ me ç'rast rezultonte që llogaritë e arkëtueshme të ishin 69,311€ apo 6,012€ më të larta se ajo që ishte shpalosur në PVF.

Mos shpalosja e saktë e llogarive të arkëtueshme zvogëlon cilësinë e PVF dhe jep një pamje jo të saktë të informacioneve në PVF.

Kjo çështje është trajtuar më larët të nënkapitulli 1.3.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 2,190€ apo rreth 20% me të ulët se vitin paraprak. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016 për shkak të vonesave të faturave dhe mbylljes së sistemit për realizimin e pagesave. ZRRUK edhe vitet e mëparshme ka treguar kujdes të shtuar lidhur me hyrjen në obligime si dhe pagesën në kohë të faturave.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të te gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të te gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Adresimi i Rekomandimeve të Vitit Paraprak	Drejtori duhet të konsideroj dhe të rishikojë mundësit, që me rastin e planifikimit të buxhetit të jepe arsyet për stafin e nevojshëm në mënyrë që të ketë një ndarje adekuate të detyrave		I adresuar në proces të implementimit	
Paga dhe Mëditje	Drejtori i ZRRUK-ut duhet të rishikoj kërkesat për punë shtesë si dhe vendimmarrja të jetë plotësisht e harmonizuar me kuadrin ligjor dhe të jetë në kohë.	I implementuar		
Llogaritë e Arketueshme	Drejtori i ZRRUK-ut duhet të insistoj që ofruesit e shërbimeve të shlyejnë me kohë dhe në mënyrë adekuate obligimet e tyre. Një alternativë e mundshme do të ishte ndryshimi i UA-së në mënyrë që të parashihen edhe masa të caktuara të cilat do të ndërgjegjësonin ofruesit e shërbimeve të jenë më të përgjegjshëm për sa i takon pagesës së taksës së licencimit.			I pa adresuar, rekomandimi përsëritet edhe këtë vit.